



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 29.11.2023, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
3. Rasim Hasani, DKA
4. Safet Krasniqi, Auditor i mbrëmshëm

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se pari ia uroj festa e nëntorit pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024
3. Diskutimi i raportit të planit të integritetit të Komunës së Lipjanit
4. Diskutimi i planit të veprimit të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së
5. Diskutimi i raportit të auditorit të mbrëmshëm dhe planit të veprimit për adresimin në rekomandimeve.
6. Propozim vendim për caktimin e veprimeve të përkohshme për trajtimin e objekteve të mbyllura shkollore.
7. Propozim vendim për miratimin e planit orientues të punës së kuvendit të komunës së Lipjanit për vitin 2024

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 20-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

II

2. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, nga DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kërkoj një sqarim qetu te dy nenet 15 mijë dhe 30 mijë.

Latif Ramadani, tha se është qëllimi te nejça prone do te jete primarë tjera sekondares do ta zgjedh vet pronari

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

3. Diskutimi i raportit të planit të integritetit të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reçica-LLugiqi, nga DKRS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se te dhënat ne plan a janë te marra nga institucioni a po dhe nga organizata tjera.

Anila Reçica-LLugiqi, tha se ne te dhënat i kemi nga institucioni jonë, jo nga organizata tjera.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Ndërsa pika e 4 dhe 5 u rekomanduan dirket per kuvend

Diskutimi i planit të veprimit të adresimit te rekomandimeve te ZKA-së

Diskutimi i raportit të auditorit të mbrëmshëm dhe planit te veprimit për adresimin ne rekomandimeve.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim vendim për caktimin e veprimeve te përkohshme për trajtimin e objekteve te mbyllura shkollore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasnait nga DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Fitim Shala, tha se kam disa pyetje nëse këto shkolla i kalojnë këshillit të fshatrave a kemi te drejt që me intervenuar ne infrastrukturë ne këto objekte dhe për çka kemi te drejt si këshill për ti shfrytëzuar.

Alban Salihu, tha se zakonisht shkollat janë shfrytëzuar për nevoja te fshatit si për ndonjë nevoje te fshatit si për fushata te partive politike. Për çka konkretisht do te shfrytëzohet kjo shkollë.

Egzona Bytqyi, po thuhet se faza e pare a do te ketë edhe faze te dyte te mbyllje se shkollave a?

Arsimn Jashari, tha se unë pajtona qe këto objekte duhet qe te i jepen në shfrytëzim fshatit për arsyes sepse po dëmtohen siç ka ndodh rasti me dy shkollat ne Banulle dhe në shkollën në Rubovc. Ne i kemi zgjedh këshillat e fshatrave dhe ata duhet te marrin nen përgjegjësi këto shkolle ne mënyre qe te mos lejohen te dëmtohen dhe te shfrytëzohen pe te mirën e këtyre qytetarëve.

Rasim Hasnait, tha se ne bazë te një udhëzimi administrativ te ministrisë thuhet se cilat shkolla mund te pezullohen, ne i kemi mbyllur këto 3 shkolla por ka mundësi vitet ne vijim te mbyllen edhe shkolla tjera. Këto shkolla do te shfrytëzohen për nevojat e banorëve. Pasi qe ta marrim vendimin ne kuvendet ne do ta bëjmë një marrëveshje me banorë e këtyre këshillave

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim vendim për miratimin e planit orientues te punës se kuvendnit te komunës se Lipjanit për vitin 2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jasshari, tha se është mire me parapa ne plan vizitohet në ndonjë vend si kuvend, po ashtu edhe propozimin e dr Egzones për pritjen e mërgimtareve ne kuvend.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi